



Nr. 18/2012  
Data: 30.08.2012

***Opinion - Qasje në pasqyrën e llogarisë së pensioneve nga të afërmit e klientit***

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia), më datën 23.07.2012, ka pranuar një kërkesë nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejme TKPK), në të cilën është kërkuar opinionin ynë nëse dhënia e pasqyrave të llogarisë së pensionit të afërmeve të klientit është në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP).

Duke u bazuar në neni 38 të LMDHP, i cili përcakton detyrën e Agjencisë për ofrimin e këshillave për institucioneve publike dhe private si dhe vendimin e Këshillit të Agjencisë për ndarjen e institucioneve sipas mbikëqyrësve, në lidhje me kërkesën e juaj, paraqesim opinionin e mëposhtëm:

**Qasja në pasqyrat e llogarisë individuale të pensionit nga të afërmit është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Sipas nenit 2 nën-paragrafi 1.1 të LMDHP, e dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm. Në këtë rast, pasqyrat individuale të pensionit janë të dhëna personale të cilat duhet të përpunohen në përputhje me ligjin.

Sipas nenit 2 nën-paragrafi 1.2 të LMDHP, përpunim i të dhënave personale është çdo veprim ose një sërë veprimesh të cilat kryhen në të dhënat personale, në këtë rast vënia në dispozicion e pasqyrave individuale të pensionit personave të afërm është përpunim i të dhënave personale.

Sipas nenit 5 nën-paragrafi 1.3 të LMDHP, të dhënat personale mund të përpunohen nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrollori. Sipas Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, konkretisht neni 7, paragrafi 7.5 dhe 7.6, TKPK ka obligim ligjor të raportojë subjektin të të dhënave një herë në vit, si dhe nëse i njëjti parashtron kërkesë për qasje në pasqyrat individuale të pensionit. Nga kjo del që TKPK nuk ka ndonjë obligim ligjor që t'u raportojë edhe të afërmeve të subjektit të të dhënave.

Qasja në llogaritë individuale në TKPK, pa plotësuar dispozitën e lartcekur, do të ishte në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave personale, respektivisht me nenin 3, paragrafi 1, në të cilin theksohet se *“të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave”*.

Përfundimisht nga opinioni i lartcekur, vënia në dispozicion e pasqyrave individuale të pensionit personave të afërm mund të bëhet nëse i afërmi ka një prokurë/autorizim të nxjerrë sipas nenit 77 dhe 79 (1) të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Qasja përmes autorizimit është në harmoni me LMDHP, konkretisht nenit 5, nën-paragrafi 1.1, i cili përcakton se të të dhënat personale mund të përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij/saj. Kjo do të nënkuptonte edhe rastin kur gjatë nënshkrimit të kontratës, subjekti i të dhënave do të jepte pëlqimin, nëse ndonjë person i afërm do të mund të kishte qasje në pasqyrat individuale të pensionit.